RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

"PËR TURIZMIN"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për turizmin" synon krijimin e një kuadri ligjor të ri, të unifikuar dhe modern për rregullimin e veprimtarive turistike, administrimin e sektorit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Republikën e Shqipërisë. Hartimi i këtij projektligji vjen si rezultat i nevojës për të rishikuar në mënyrë tërësore legjislacionin ekzistues, me qëllim përshtatjen e tij me zhvillimet e vrullshme që ka njohur sektori turistik në vitet e fundit, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Zhvillimi i turizmit si një nga sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare, rritja e ndjeshme e flukseve turistike, zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara dhe transformimi i mënyrës së organizimit dhe tregtimit të tyre kanë nxjerrë në pah nevojën për një kuadër rregullator më të qartë dhe më gjithëpërfshirës. Përvoja e zbatimit të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, ka evidentuar nevojën për konsolidimin e dispozitave ekzistuese, eliminimin e mbivendosjeve dhe paqartësive, si dhe përfshirjen e rregullimeve të reja që pasqyrojnë realitetin aktual të tregut turistik.

Në veçanti, zhvillimi i sistemeve digjitale, përhapja e formave të reja të akomodimit, rritja e rolit të ndërmjetësve elektronikë në rezervimin dhe shitjen e shërbimeve turistike, si dhe nevoja për administrimin më efikas të të dhënave dhe statistikave të fushës, kërkojnë një bazë ligjore më të plotë dhe më funksionale. Në këtë drejtim, projektligji synon të krijojë mekanizma që garantojnë formalizimin e aktivitetit turistik, rritjen e transparencës së tregut, përmirësimin e gjurmueshmërisë së operatorëve ekonomikë dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe zhvillimin e fushës.

Njëkohësisht, projektligji synon të sigurojë një nivel më të lartë sigurie juridike për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit, nëpërmjet përcaktimit më të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të tyre, thjeshtimit dhe modernizimit të procedurave administrative, si dhe përmirësimit të standardeve që lidhen me

ushtrimin e veprimtarive turistike. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve synohet krijimi i një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e sipërmarrjes, nxitjen e investimeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ofertës turistike shqiptare.

Projektligji synon gjithashtu forcimin e mbrojtjes së turistëve dhe konsumatorëve të shërbimeve turistike, garantimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të ofruara, si dhe përmirësimin e mekanizmave administrativë dhe institucionalë për mbikëqyrjen e fushës. Në këtë mënyrë, synohet të krijohen kushtet për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, i cili kontribuon në rritjen ekonomike, zhvillimin e territorit, përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve pritëse dhe promovimin e Shqipërisë si një destinacion turistik konkurrues në tregun rajonal dhe ndërkombëtar.

Po ashtu, projektligji synon avancimin e mëtejshëm të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e shërbimeve dhe turizmit. Nëpërmjet këtyre rregullimeve krijohen kushtet për zhvillimin e një tregu turistik modern, transparent dhe konkurrues, në përputhje me standardet evropiane dhe objektivat strategjikë të zhvillimit të fushës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është parashikuar në Programin Analitik të Akteve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për vitin 2026 dhe është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave për periudhën 2025-2029, si dhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030, miratuar me vendimin nr. 466, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi i projektligjit "Për turizmin" diktohet nga nevoja për krijimin e një kuadri ligjor të konsoliduar dhe të përditësuar, i aftë për t'iu përgjigjur zhvillimeve që ka njohur sektori i turizmit gjatë viteve të fundit, si dhe sfidave që lidhen me administrimin, formalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Edhe pse ligji nr. 93/2015, "Për turizmin", i ndryshuar, ka krijuar bazën e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e fushës, zbatimi i tij në praktikë ka evidentuar një sërë çështjesh që kërkojnë trajtim më të plotë dhe më sistematik sesa ai që mund të arrihet përmes ndryshimeve të pjesshme dhe të vazhdueshme të ligjit ekzistues.

Gjatë viteve të fundit, sektori i turizmit ka përjetuar ndryshime të rëndësishme strukturore. Rritja e konsiderueshme e numrit të vizitorëve, zgjerimi i kapaciteteve akomoduese, shfaqja e modeleve të reja të investimit dhe zhvillimi i sistemeve digjitale për rezervimin dhe ofrimin e shërbimeve turistike kanë krijuar realitete të reja ekonomike dhe administrative, të cilat nuk gjejnë pasqyrim të plotë në kuadrin aktual ligjor. Për pasojë, janë evidentuar hapësira në kuadrin rregullator që ndikojnë në identifikimin e operatorëve ekonomikë, monitorimin e veprimtarive turistike, administrimin e të dhënave sektoriale dhe garantimin e kushteve të barabarta të konkurrencës në treg.

Në veçanti, zhvillimi i shpejtë i njësive akomoduese për qëndrime afatshkurtra ka nxjerrë në pah nevojën për krijimin e mekanizmave të qartë të regjistrimit dhe identifikimit të tyre. Mungesa e një kuadri të posaçëm për administrimin e kësaj veprimtarie kufizon mundësinë e institucioneve për të disponuar të dhëna të plota dhe të sakta mbi kapacitetet reale akomoduese të vendit, duke ndikuar si në procesin e planifikimit të politikave publike, ashtu edhe në nivelin e formalizimit të sektorit. Për këtë arsye, ndërhyrja ligjore vlerësohet e nevojshme për të siguruar transparencë më të madhe, gjurmueshmëri të veprimtarive ekonomike dhe administrim më efikas të informacionit turistik.

Duhet theksuar se dispozitat e projektligjit që rregullojnë përzgjedhjen, financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nuk përbëjnë një mekanizëm të ri ligjor. Procedura të tilla parashikohen edhe në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, i cili njeh mundësinë e financimit të projekteve në fushën e turizmit dhe përcakton se këto procedura nuk i nënshtrohen legjislacionit për prokurimin publik. Projektligji ruan këtë qasje dhe synon kryesisht sistematizimin, qartësimin dhe përmirësimin e rregullimit ekzistues, pa krijuar procedura të reja prokurimi apo mekanizma të rinj financiarë.

Po kështu, përvoja e zbatimit të legjislacionit në fuqi ka treguar nevojën për përmirësimin e rregullave që lidhen me standardet e shërbimeve turistike dhe funksionimin e strukturave akomoduese. Rritja e konkurrencës në tregun turistik dhe pritshmëritë gjithnjë e më të larta të turistëve kërkojnë një sistem më efektiv rregullimi, monitorimi dhe garantimi të cilësisë së shërbimeve. Në mungesë të një kuadri të përditësuar, ekziston rreziku që zhvillimi sasior i sektorit të mos shoqërohet me përmirësimin e standardeve dhe të cilësisë së ofertës turistike.

Nevoja për ndërhyrje ligjore lidhet gjithashtu me zhvillimet institucionale dhe kërkesën për mekanizma më efikasë të administrimit të fushës. Praktika ka treguar se menaxhimi i të dhënave, koordinimi ndërinstitucional dhe monitorimi i tregut

turistik kërkojnë instrumente më të avancuara administrative dhe digjitale, të cilat duhet të mbështeten mbi një bazë ligjore të qartë dhe të qëndrueshme. Në këtë drejtim, projektligji synon të krijojë kushtet për administrim më të mirë të informacionit turistik, përmirësim të proceseve vendimmarrëse dhe forcim të kapaciteteve institucionale për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sektorit.

Kompleksiteti në rritje i marrëdhënieve ndërmjet operatorëve turistikë dhe konsumatorëve, veçanërisht në mjedisin digjital, kërkon rregulla më të qarta dhe instrumente më efektive për garantimin e të drejtave të tyre. Kjo nevojë bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur sektori i turizmit po zgjerohet vazhdimisht dhe kur mbrojtja e konsumatorit përbën një nga elementet themelore të besueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së destinacionit turistik.

Ndërkohë, procesi i integrimit evropian dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë imponojnë nevojën për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me standardet dhe praktikat evropiane në fushën e turizmit dhe të shërbimeve. Kuadri aktual nuk i adreson në mënyrë të plotë të gjitha kërkesat që rrjedhin nga zhvillimi i acquis të Bashkimit Evropian dhe nga angazhimet rajonale në fushën e lëvizjes së shërbimeve. Për rrjedhojë, projektligji krijon bazën e nevojshme ligjore për avancimin e këtij procesi dhe për garantimin e përputhshmërisë graduale të legjislacionit shqiptar me standardet evropiane.

Në këto kushte, përparësia kryesore e projektligjit qëndron në krijimin e një kuadri ligjor të integruar dhe koherent, i cili adreson në mënyrë të njëtrajtshme problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit ekzistues, përshtatet me zhvillimet aktuale të tregut dhe krijon bazat për zhvillimin afatgjatë të sektorit. Miratimi i tij pritet të sjellë rritjen e formalizimit të veprimtarive turistike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, forcimin e mbrojtjes së turistëve dhe konsumatorëve, përmirësimin e administrimit institucional dhe të të dhënave sektoriale, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë së turizmit shqiptar në tregun rajonal dhe ndërkombëtar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është në harmonizim me legjislacionin për licencat, autorizimet dhe lejet, procedurat administrative, mbrojtjen e

konsumatorëve, inspektimin, statistikat zyrtare, mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin sektorial të transportit e të territorit. Aktet nënligjore zbatuese duhet të sigurojnë respektimin e parimeve të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji përmban dispozita që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e turizmit me Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Për shërbimet në tregun e brendshëm", si dhe me Direktivën (BE) 2015/2302 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 25 nëntor 2015, "Për paketat e udhëtimit dhe organizimet e lidhura të udhëtimit", të ndryshuar me Direktivën (BE) 2026/1024 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2026.

Përafrimi synon lehtësimin e ushtrimit të veprimtarive turistike, garantimin e trajtimit jodiskriminues të ofruesve të shërbimeve, përcaktimin e kritereve të qarta, objektive dhe proporcionale, si dhe forcimin e mbrojtjes së udhëtarëve. Në lidhje me paketat e udhëtimit, projektligji përcakton përkufizimet përkatëse, kushtet dhe kriteret për krijimin e paketave të udhëtimit, si dhe kërkesat bazë për kontratat me udhëtarët. Rregullat e hollësishme për të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratat e paketave të udhëtimit përcaktohen në legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit dhe në aktet nënligjore përkatëse.

Gjithashtu, projektligji parashikon që dispozitat e veçanta për ofruesit e shërbimeve të vendosur ligjërisht në shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe të Zonës Ekonomike Europiane të zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, sipas përcaktimeve të projektligjit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji "Për turizmin" paraqitet si një akt i ri ligjor, i cili zëvendëson ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, duke konsoliduar kuadrin ligjor ekzistues dhe duke përfshirë rregullime të reja që pasqyrojnë zhvillimet e sektorit, procesin e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Projektligji synon krijimin e një kuadri më të qartë, më koherent dhe më të përshtatur me nevojat aktuale të zhvillimit të turizmit, duke forcuar standardet e shërbimit,

mbrojtjen e turistëve, formalizimin e veprimtarive turistike dhe koordinimin institucional.

Projektligji është i strukturuar në 15 krerë, të cilët rregullojnë organizimin institucional, planifikimin e zhvillimit të turizmit, mbështetjen financiare, investimet turistike, ushtrimin e veprimtarive turistike, mbrojtjen e konsumatorëve, statistikat, edukimin në fushën e turizmit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky kre përcakton qëllimin, objektin, subjektet dhe fushën e zbatimit të ligjit, si dhe përkufizimet bazë që përdoren në të. Dispozitat e tij rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike, sipërmarrjeve turistike dhe aktorëve të tjerë që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit.

Projektligji përditëson dhe zgjeron terminologjinë ligjore në përputhje me zhvillimet e tregut turistik, duke përfshirë forma të reja të akomodimit, si njësitë akomoduese për qëndrime afatshkurtra, strukturat e njësive akomoduese të menaxhuara, hotelet e shpërndara dhe resortet mikse. Gjithashtu, përfshihen përkufizime të reja që lidhen me paketat e udhëtimit, rezervimet online, shërbimet turistike dhe kategoritë e ndryshme të sipërmarrjeve turistike.

Neni 3 parashikon që, nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ofruesit e shërbimeve të vendosur në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Zonës Ekonomike Evropiane të gëzojnë trajtim të barabartë me ofruesit vendas, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

KREU II – PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT DHE INVESTIMET NË ZHVILLIMIN E TIJ

Ky kre përcakton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, duke garantuar balancën ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së vlerave sociale e kulturore.

Gjithashtu, investimet në turizëm njihen si veprimtari me interes publik dhe përcaktohen kushtet për përfitimin e mbështetjes dhe lehtësive të parashikuara nga ligji. Projektligji parashikon gjithashtu kufizime për subjektet që ndodhen në kushtet ndaluese të përcaktuara nga ligji, me qëllim garantimin e integritetit, transparencës dhe ligjshmërisë së investimeve turistike.

KREU III – KUADRI INSTITUCIONAL DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

PËR TURIZMIN

Ky kre përcakton institucionet përgjegjëse për turizmin, funksionet e tyre dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional për zhvillimin dhe administrimin e sektorit.

Një ndër ndryshimet kryesore lidhet me zgjerimin dhe ripërcaktimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, e cila vijon veprimtarinë si agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve, duke ruajtur personalitetin juridik, të drejtat dhe detyrimet e saj. Krahas promovimit të Shqipërisë si destinacion turistik, agjencia ushtron funksione që lidhen me organizimin, bashkëorganizimin, financimin, mbështetjen dhe promovimin e veprimtarive me interes për turizmin, me qëllim diversifikimin e ofertës turistike dhe zgjatjen e sezonit turistik. Gjithashtu, projektligji parashikon zhvillimin dhe administrimin e Platformës Kombëtare Digjitale të Promovimit Turistik dhe Informacionit për Vizitorët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Projektligji parashikon gjithashtu riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit si agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore. Agjencia ushtron funksione që lidhen me administrimin dhe monitorimin e plazheve dhe stacioneve të plazhit, zhvillimin e sistemeve dhe regjistrave digjitalë, koordinimin e projekteve për turizmin bregujor dhe mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore. Projektligji parashikon që agjencia të financohet nga fondet e buxhetit të shtetit, të ardhurat e veta dhe burime të tjera të ligjshme, me qëllim forcimin e kapaciteteve të saj administrative dhe operacionale.

Ky kre rregullon gjithashtu funksionimin e Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit, Komitetit për të Dhënat Statistikore në Turizëm, strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit, Zyrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike, si dhe rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit.

KREU IV – PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Ky kre rregullon planifikimin e zhvillimit të turizmit, klasifikimin dhe administrimin e burimeve turistike, hartimin e Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit dhe menaxhimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.

Projektligji përcakton rregulla më të detajuara për identifikimin, inventarizimin dhe administrimin e burimeve turistike, si dhe për krijimin dhe administrimin e

Regjistrit Kombëtar të Burimeve Turistike.

Një rregullim i rëndësishëm lidhet me procedurat për shpalljen, administrimin dhe ndryshimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, si instrument i politikave shtetërore për zhvillimin e destinacioneve turistike.

Projektligji përfshin rregulla të posaçme për standardizimin, regjistrimin, kategorizimin, sinjalistikën dhe administrimin e shtigjeve turistike, duke përcaktuar rregulla për projektimin, hapjen, regjistrimin, kategorizimin, sinjalistikën dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe parashikon ngritjen e Komisionit Kombëtar të Shtigjeve Turistike.

Një tjetër rregullim lidhet me pezullimin sezonal të punimeve të ndërtimit dhe aktiviteteve të lidhura me to në zonat turistike, me qëllim mbrojtjen e sezonit turistik dhe garantimin e cilësisë së përvojës së vizitorëve.

KREU V – MBËSHTETJA FINANCIARE E PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

Ky kre përcakton mënyrën e financimit dhe bashkëfinancimit të projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit.

Projektligji parashikon që financimi të realizohet si nga ministria përgjegjëse për turizmin, ashtu edhe nga agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve, brenda fondeve buxhetore të miratuara për këtë qëllim.

Përcaktohen kategoritë e projekteve që mund të financohen, procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tyre, si dhe kompetencat e kolegjiumeve përkatëse të vlerësimit. Projektligji parashikon mundësinë e financimit deri në 100% të kostove të miratuara të projekteve ose veprimtarive, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara.

KREU VI – INVESTIMET NË TURIZËM

Ky kre përcakton kuadrin ligjor për zhvillimin e investimeve turistike, format e partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe privat, kushtet për përfitimin e statusit "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special", si dhe rregullat për administrimin dhe vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në funksion të zhvillimit të turizmit.

Projektligji parashikon mundësinë e përdorimit të formave të ndryshme të partneritetit për realizimin e investimeve turistike në zonat me përparësi zhvillimin

e turizmit, duke përfshirë partneritetet publiko-private, pjesëmarrjen me aksione në sipërmarrje turistike, vënien në dispozicion të pasurive shtetërore dhe sigurimin e infrastrukturës mbështetëse.

Përcaktohen kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të veçantë për investimet në struktura akomoduese me 4 ose 5 yje, si dhe rregullat për administrimin e pasurive shtetërore të destinuara për zhvillimin e investimeve turistike.

Projektligji rregullon gjithashtu marrëveshjet e zhvillimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe investitorëve, të drejtat dhe detyrimet e palëve, transferimin e të drejtave të investitorëve, si dhe pasojat që lidhen me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Këto dispozita synojnë krijimin e një kuadri më të qartë dhe më të sigurt për investimet turistike dhe administrimin e pasurive shtetërore të përdorura për këtë qëllim.

KREU VII – STRUKTURAT AKOMODUESE

Ky kre rregullon kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese, regjistrimin e njësive akomoduese për qëndrime afatshkurtra, certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe rastet e ndërprerjes së ushtrimit të veprimtarisë.

Një ndër rregullimet kryesore lidhet me sistemin e kategorizimit të strukturave akomoduese, ku certifikata e kategorizimit lëshohet pa afat vlefshmërie, për aq kohë sa subjekti vijon të përmbushë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj.

Projektligji parashikon gjithashtu regjistrimin e detyrueshëm të njësive akomoduese për qëndrime afatshkurtra nëpërmjet portalit e-Albania dhe pajisjen e secilës njësi me kod unik regjistrimi.

Në fushën e klasifikimit, projektligji parashikon që certifikata e klasifikimit të lëshohet pa afat vlefshmërie dhe të mbetet në fuqi për sa kohë struktura akomoduese përmbush kriteret dhe standardet përkatëse. Strukturat akomoduese i nënshtrohen rivlerësimit të klasifikimit çdo pesë vjet nga ministria përgjegjëse për turizmin, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kritereve dhe standardeve të përcaktuara.

KREU VIII – AGJENCITË E UDHËTIMIT DHE OPERATORËT TURISTIKË

Ky kre rregullon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së agjencive të udhëtimit dhe

operatorëve turistikë, procedurat e licencimit, raportimin e të dhënave dhe marrëdhëniet kontraktore me udhëtarët.

Projektligji përfshin dispozita të posaçme për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga CEFTA, duke parashikuar rregulla për ofrimin e përkohshëm dhe rastësor të shërbimeve nga agjenci udhëtimi dhe operatorë turistikë të vendosur ligjërisht në Palët e CEFTA-s.

Gjithashtu, përcaktohen kërkesat minimale për kontratat me udhëtarët dhe mbrojtjen e tyre, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për paketat e udhëtimit.

Në nenin 60 të projektligjit përcaktohen kushtet dhe kriteret për krijimin e paketave të udhëtimit, përfshirë kombinimin e shërbimeve të ndryshme të udhëtimit, rastet e rezervimeve nëpërmjet proceseve të lidhura online dhe përjashtimet nga përkufizimi i paketës së udhëtimit. Përcaktohen gjithashtu kërkesat bazë për kontratat e paketave të udhëtimit, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të udhëtarëve.

KREU IX – UDHËRRËFYESI TURISTIK

Ky kre rregullon kategoritë e udhërrëfyesve turistikë, kushtet e certifikimit, dokumentet identifikuese, edukimin profesional dhe ushtrimin e veprimtarisë nga udhërrëfyesit e huaj.

Projektligji përfshin dispozita të posaçme për ofrimin e shërbimeve nga udhërrëfyesit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane, të cilat do të zbatohen pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

KREU X – TRANSPORTI TURISTIK DHE SIPËRMARRJET E TJERA TURISTIKE

Ky kre rregullon transportin turistik, shërbimin turistik të vizitave panoramike me autobus (Open Bus/Hop-on Hop-off), funksionimin e stacioneve të plazhit dhe detyrimet e tjera të sipërmarrjeve turistike.

Përcaktohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit turistik, standardet për administrimin e stacioneve të plazhit, garantimin e aksesit publik në plazhe, si dhe detyrimet që lidhen me sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta dhe mbrojtjen financiare të udhëtarëve.

KREU XI – STATISTIKAT

Ky kre përcakton parimet dhe procedurat për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave statistikore në fushën e turizmit.

Projektligji parashikon ngritjen e Sistemit të të Dhënave në Turizëm nga ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për koordinimin e bazave të të dhënave shtetërore. Gjithashtu, përcaktohen rregulla për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe detyrimet e raportimit nga strukturat akomoduese, agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, me qëllim përmirësimin e informacionit statistikor në fushën e turizmit.

KREU XII – EDUKIMI NË FUSHËN E TURIZMIT

Ky kre trajton objektivat e edukimit, formimit profesional, trajnimit dhe kërkimit shkencor në fushën e turizmit, me qëllim zhvillimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve turistike.

KREU XIII – BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Ky kre përcakton format e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit dhe marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare, duke synuar shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

KREU XIV – KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Ky kre përcakton shkeljet administrative, masat ndëshkimore përkatëse, procedurat e ankimit dhe administrimin e të ardhurave nga gjobat.

KREU XV – DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Ky kre përmban dispozitat e nevojshme për kalimin nga kuadri ligjor ekzistues në kuadrin e ri ligjor, duke garantuar vijimësinë juridike dhe administrative të marrëdhënieve, procedurave dhe veprimtarive të rregulluara në fushën e turizmit. Në të përcaktohen afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, vijimësia e zbatimit të akteve nënligjore ekzistuese për aq sa nuk bien ndesh me dispozitat e tij, si dhe trajtimi i procedurave administrative të filluara përpara hyrjes në fuqi të ligjit.

Ky kre parashikon gjithashtu dispozita të posaçme që lidhen me zbatimin e rregullave të përafruara me legjislacionin e Bashkimit Evropian, të cilat do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në

Bashkimin Evropian, sipas përcaktimeve të projektligjit. Njëkohësisht, parashikohen dispozitat shfuqizuese për ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, si dhe hyrja në fuqi e ligjit të ri.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për ekonominë, agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve, agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit, struktura përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në fushën e turizmit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe institucionet e tjera publike që ushtrojnë funksione në fushën e turizmit, sipas kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Për shkak të karakterit ndërsektorial të projektaktit, projektakti do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Institutit të Statistikave.

Projektligji do t'i nënshtrohet konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik, duke u publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), ku do të jetë i hapur për paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve gjatë periudhës 28 tetor- 25 nëntor 2026.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe do të zhvillohen disa tryeza konsultative me përfaqësues të industrisë turistike, shoqatat e hotelerisë dhe turizmit, operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit "Për turizmin" parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit, të lidhura kryesisht me ngritjen e strukturave të reja institucionale dhe zhvillimin e sistemeve digjitale të parashikuara në projektligj.

Një nga ndërhyrjet kryesore të projektligjit lidhet me krijimin e Zyrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM), pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, e cila do të ushtrojë funksionet e trajtimit dhe zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike. Funksionimi i kësaj strukture do të kërkojë mbështetje administrative, burime njerëzore dhe fonde operative të nevojshme për ushtrimin efektiv të kompetencave.

Projektligji parashikon gjithashtu krijimin e Sistemit të të Dhënave në Turizëm (SDT), si një sistem kombëtar të integruar për administrimin, përpunimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave në fushën e turizmit. Në kuadër të zhvillimit të këtij sistemi parashikohet integrimi i të dhënave dhe funksionaliteteve përkatëse, përfshirë Regjistrin Qendror të Turizmit dhe komponentët elektronikë e analitikë të nevojshëm për prodhimin e statistikave dhe mbështetjen e politikëbërjes në fushën e turizmit.

Për realizimin e këtij projekti është parashikuar një kërkesë financimi në vlerën 300,000,000 (treqind milionë) lekë, e propozuar në kuadër të programimit buxhetor për vitin 2027. Kjo vlerë përfshin përgatitjen e dokumentacionit teknik, zhvillimin e sistemit, integrimin me sistemet shtetërore ekzistuese, testimin dhe vënien në funksion të sistemit, si dhe trajnimin e përdoruesve dhe administratorëve të tij.

Përveç investimit fillestar, funksionimi i sistemit do të shoqërohet me kosto të vazhdueshme për mirëmbajtjen, përditësimin, mbështetjen teknike dhe garantimin e sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve digjitale.

Gjithashtu, zbatimi i projektligjit mund të kërkojë fonde shtesë për funksionimin e strukturave të reja institucionale, për zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale, si dhe për zbatimin e akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të tij.

Vlerësimi i plotë i efekteve financiare, përfshirë kostot e ngritjes dhe funksionimit të Zyrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të të Dhënave në Turizëm, si dhe nevojat e tjera financiare

që lidhen me zbatimin e projektligjit, do të paraqitet në mënyrë të detajuar në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), në përputhje me metodologjinë dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në fazën aktuale nuk parashikohen të ardhura buxhetore të drejtpërdrejta që burojnë nga ngritja e Zyrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve dhe nga krijimi i Sistemit të të Dhënave në Turizëm. Megjithatë, në afat të mesëm dhe afatgjatë, këto masa pritet të kontribuojnë në përmirësimin e formalizimit të veprimtarive turistike, rritjen e cilësisë së të dhënave statistikore dhe forcimin e administrimit të sektorit të turizmit.

MINISTËR

Blendi Gonxhja

Digitally signed by Blendi Gonxhja
Date: 2021.11.09 14:27:53 +02'00'